

SKEDË INFORMUESE

Mundësi për Bashkitë për aplikim në Thirrjen e 4-rt të programit Interreg IPA South Adriatic

Programi Interreg IPA South Adriatic është një program bashkëpunimi ndërkufitar i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA III) për periudhën 2021–2027, që përfshin Italinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi.

Kjo thirrje është pjesë e Mekanizmit Shumë-Programor për Mesdheun (Mediterranean Multi-Programme Mechanism (MMM)) dhe synon të forcojë bashkëpunimin dhe transferimin e rezultateve të projekteve ekzistuese në fushën e turizmit të qëndrueshëm në territore të ndryshme të Mesdheut.

1. Synimi i thirrjes

Thirrja synon të mbështesë projekte të vogla të **kapitalizimit** që përdorin, transferojnë, përshtatin, testojnë ose zgjerojnë rezultate, mjete, metodologji, strategji, plane veprimi apo zgjidhje të zhvilluara më parë në kuadër të programeve Interreg pjesëmarrëse në Mediterranean Multi-Programme Mechanism (MMM). Pra, kjo nuk është një thirrje për zhvillimin e një projekti tërësisht të ri nga e para. Elementi kryesor është kapitalizimi i rezultateve ekzistuese dhe përdorimi i tyre në një kontekst të ri territorial ose institucional. Çdo projekt i paraqitur në kuadër të kësaj thirrjeje duhet të bazohet **në të paktën një output** të identifikuar në **MMM Outputs Database**, i cili duhet të jetë zhvilluar nga një program MMM tjetër dhe jo nga vetë Interreg IPA South Adriatic. Bashkia dhe partnerët e tjerë që aplikojnë duhet të veprojnë si “TAKERS”, pra si përdorues dhe përfitues të një rezultati ekzistues të zhvilluar nga një projekt ose program tjetër. Kapitalizimi mund të realizohet përmes transferimit të një zgjidhjeje ekzistuese, përshtatjes së saj me kushtet e territorit shqiptar, testimit në praktikë ose zgjerimit të përdorimit të saj. Thirrja synon që rezultatet e projekteve të mëparshme të mos mbeten të kufizuara në territorin ku janë zhvilluar fillimisht, por të transferohen dhe përdoren në territore të tjera të hapësirës së Mesdheut.

Për bashkitë shqiptare, kjo do të thotë se një ide e përshtatshme duhet të lidhet me një zgjidhje ekzistuese të identifikuar në MMM Outputs Database dhe të shpjegojë qartë se si ajo zgjidhje do të përdoret, përshtatet ose testohet në territorin e bashkisë.

2. Fushat e veprimit:

Aplikimi duhet të zgjedhë një nga katër temat, të gjitha brenda objektivit për forcimin e kapaciteteve institucionale:

1. Qeverisja e përbashkët dhe strategjike e ofertës turistike.
2. Turizmi dhe tranzicioni i gjelbër.

3. Punësimi, aftësitë dhe turizmi gjithëpërfshirës e i aksesueshëm.
4. Produkte turistike novatore dhe inteligjente.

3. Kush mund të aplikojë

Partnerët e pranueshëm për aplikim janë:

- Institucionet publike;
- Organet e rregulluara nga e drejta publike;
- Organizatat private jofitimprurëse, të themeluara në përputhje me kuadrin ligjor/ligjin në fuqi në vendin përkatës, për të cilat kapaciteti financiar duhet të demonstrohet dhe të vlerësohet bazuar në përgjegjshmërinë financiare dhe parimet e zbatuara gjerësisht (shihni mjetin e ofruar).

Partnerët duhet të jenë të vendosur në një nga tre vendet e Programit: Itali, Shqipëri ose Mal i Zi. Për Shqipërinë, territori i plotë i vendit është pjesë e zonës së Programit.

Për këtë thirrje, një projekt duhet të përfshijë partnerë nga **të paktën dy vende** pjesëmarrëse, dhe **të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga Italia**.

Numri total i partnerëve **nuk mund të jetë më i madh se katër partnerë**, duke përfshirë Lead Partner-in. Çdo partner duhet të ketë një rol të përcaktuar në kapitalizimin e rezultatit të zgjedhur. Partneriteti duhet të demonstrojë se ka kapacitetin institucional, njerëzor dhe teknik për të zbatuar aktivitetet e propozuara.

Një bashki shqiptare mund të jetë Lead Partner ose Project Partner, në varësi të strukturës së partneritetit dhe rolit të saj në projekt. Megjithatë, duke qenë se kërkohet pjesëmarrja e të paktën një partneri italian, një bashki shqiptare nuk mund të paraqesë një projekt vetëm me partnerë shqiptarë.

Organizata jofitimprurëse private janë gjithashtu të pranueshme, por duhet të kenë qenë operative për të paktën 12 muaj përpara hapjes së thirrjes dhe duhet të plotësojnë kërkesat për kapacitetin financiar.

Partneri që ka zhvilluar fillimisht rezultatin që do të kapitalizohet, i quajtur “GIVER”, nuk është i detyrueshëm të jetë pjesë e partneritetit. Megjithatë, përfshirja e tij si partner ose Associate Partner mund të jetë e dobishme dhe mund të vlerësohet pozitivisht në procesin e përzgjedhjes.

Një organizatë mund të aplikojë si Lead Partner ose Project Partner në maksimumi një projekt në kuadër të kësaj thirrjeje.

3. Cilat janë fushat dhe aktivitetet e mbështetura

Thirrja mbështet vetëm projekte që lidhen me turizmin e qëndrueshëm dhe me forcimin e kapaciteteve institucionale në kuadër të objektivit specifik S.O. 5.1 “Rritja e kapaciteteve

institucionale të autoriteteve publike, veçanërisht atyre të ngarkuara me menaxhimin e një territori specifik, dhe të palëve të interesuara”,

Projekti duhet të përqendrohet vetëm në një nga katër temat prioritare të përcaktuara nga thirrja.

3.1 Qeverisja e përbashkët dhe strategjike e ofertës turistike

Projektet mund të synojnë krijimin ose forcimin e mekanizmave të qeverisjes shumë-nivelëshe dhe ndërsektoriale të turizmit. Aktivitetet mund të përfshijnë krijimin e strukturave të përhershme të koordinimit, platformave dixhitale, observatorëve turistikë, mekanizmave të vendimmarrjes të bazuar në të dhëna, trajnimeve, peer-learning, workshopeve dhe mekanizmave të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe të rinjve. Mund të financohen gjithashtu aktivitete për integrimin e rezultateve të projekteve në strategji dhe plane territoriale, përmes policy briefs, toolkits, rekomandimeve dhe dokumenteve të politikave.

3.2 Turizmi dhe tranzicioni i gjelbër

Projektet mund të fokusohen në zgjidhje që lidhin turizmin me mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e burimeve natyrore, zhvillimin territorial dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Aktivitetet mund të përfshijnë testimin dhe përshtatjen e modeleve të turizmit të gjelbër, shkëmbimin e praktikave, peer reviews, platforma të përbashkëta të menaxhimit të njohurive, angazhimin e komunitetit dhe të rinjve dhe integrimin e zgjidhjeve të testuara në mekanizmat lokalë të qeverisjes.

3.3 Dimensioni social i turizmit, punësimi, aftësitë, përfshirja dhe aksesueshmëria

Kjo fushë mbështet projekte që synojnë përmirësimin e aftësive profesionale dhe punësimit në turizëm, veçanërisht për të rinjtë, si dhe zhvillimin e turizmit gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm. Aktivitetet mund të përfshijnë trajnime, reskilling dhe upskilling, zhvillimin e rrugëve të reja profesionale, mekanizma për përmirësimin e cilësisë së punësimit dhe zgjidhje të bazuara në parimet e aksesueshmërisë universale. Në këtë kuadër mund të përfshihen edhe fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera që mund të përballen me barriera në aksesin ndaj produkteve dhe shërbimeve turistike.

3.4 Produkte turistike inovative dhe smart

Projektet mund të përdorin zgjidhje dixhitale dhe teknologjike për zhvillimin e turizmit, përfshirë platformat dixhitale, inteligjencën artificiale, realitetin virtual, zgjidhjet e pagesave dhe mjete të tjera për përmirësimin e përvojës turistike dhe efikasitetit operacional. Mund të mbështeten gjithashtu aktivitete që krijojnë kapacitete për inovacion, trajnime për SME-të dhe start-up-et, partneritete publike-private, Living Labs, hackathons dhe mekanizma për përfshirjen e të rinjve dhe qytetarëve në bashkëprojektimin e zgjidhjeve.

4. Cilat janë zonat përfituese

Zona e Programit përfshin Italinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi. Në Itali përfshihen rajonet Puglia dhe Molise. Në Shqipëri përfshihet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë, pra të gjitha bashkitë shqiptare janë brenda zonës së pranueshme territoriale. Në Malin e Zi përfshihet i gjithë territori i vendit. Për shkak të natyrës së thirrjes, bashkia nuk duhet të propozojë thjesht një aktivitet lokal. Projekti duhet të tregojë pse bashkëpunimi me partnerin italian dhe, nëse është rasti, partnerin malazez, është i nevojshëm për transferimin, përshtatjen, testimin ose zgjerimin e rezultatit të zgjedhur.

5. Cili është buxheti i thirrjes dhe për projekt

Buxheti i përgjithshëm i thirrjes është 1,034,902.40 euro.

Nga kjo shumë, 853,587.16 euro janë kontribut IPA dhe 181,315.40 euro janë bashkëfinancim kombëtar.

Buxheti maksimal i një projekti është **200,000 euro**, duke përfshirë kontributin IPA dhe bashkëfinancimin kombëtar.

Nuk përcaktohet një buxhet minimal për partner.

Për partnerët shqiptarë dhe malazezë zbatohet një normë bashkëfinancimi prej **85% IPA dhe 15% bashkëfinancim kombëtar**. Për partnerët italianë norma e IPA është 80%, ndërsa bashkëfinancimi kombëtar italian është i garantuar.

6. Cilat janë kostot e pranueshme

Kjo thirrje ka një karakter të veçantë financiar sepse projektet Small-Scale financohen vetëm përmes Simplified Cost Options (SCOs) dhe nuk funksionojnë me rimbursimin e kostove reale individuale. Kostot e pranueshme përfshihen në kategoritë e përcaktuara nga Programi, përkatësisht lump sum për përgatitjen e projektit, lump sum për workshope, seminare dhe konferenca, lump sum për misione hyrëse dhe takime B2B, lump sum për accompanying actions, Simplified Specific Unit Costs për trajnime të targetuara, Simplified Specific Unit Costs për udhëtime dhe akomodim, si dhe lump sum për Joint Action Plan, Model ose Methods.

Për partnerët italianë parashikohet gjithashtu një normë prej 2% për kostot e First Level Control.

Për përgatitjen e projektit, kostot e kryera përpara fillimit të projektit nuk rimbursohen si kosto reale. Në vend të tyre, parashikohet një lump sum prej 5,585 EUR, që mbulon përgatitjen e projektit dhe i akordohet Lead Partner-it.

Projektet duhet të hartohen duke respektuar metodologjinë e Simplified Cost Options të Programit dhe udhëzimet përkatëse të Small-Scale Projects. Për një bashki shqiptare kjo do të thotë se buxheti duhet të ndërtohet mbi aktivitetet dhe rezultatet që do të realizohen, duke përdorur kategoritë e

standardizuara të kostove të përcaktuara nga Programi dhe jo duke paraqitur një listë të zakonshme të shpenzimeve reale të projektit.

7. Si bëhet aplikimi

Aplikimi bëhet vetëm online përmes Jems – Electronic Monitoring System të Interreg IPA South Adriatic:

Aplikimi paraqitet në një fazë të vetme nga Lead Partner-i në emër të të gjithë partneritetit.

Dokumentacioni kryesor përfshin Application Form, deklaratat e Lead Partner-it dhe Project Partners, dokumentet që dëshmojnë kompetencën për nënshkrim, dokumentet e identitetit të përfaqësuesve ligjorë, dokumentet statutore ose aktet ligjore të institucionit kur kërkohen, si dhe dokumentacionin financiar për partnerët privatë.

8. Kur është afati i fundit

Afati përfundimtar është **21 dhjetor 2026, ora 11:59 AM.**

9. Linku i thirrjes:

Linku i thirrjes (kërkoni për Thirrjen 4): <https://southadriatic.eu/look-for-funding#calcalendar>